



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-16421/22
Kaçanik, 27.06.2022


Në mbështetje të nenit 12.1 si dhe nenit 40.2 pika e) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, të Rregullores Nr.01/2020 -Për Ndryshim Plotësimin e Rregullores 01/2018(01.NR.02-104/01-11899/18) Për Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës së Kaçanikut, të Propozim vendimit të Kryetarit të komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 Qershor 2022 mori këtë:

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale me këtë përbërje, Katër (4) anëtarë propozohen nga Kuvendi i Komunës nga subjekte të ndryshme politike, një (1) anëtar propozohet nga ekzekutivi i Komunës, një (1) anëtar nga shoqëria civile, dhe një (1) anëtar përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjes urbane.
2. Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale ka këtë përbërje:
 1. **Fatmir Bunjaku- PDK**
 2. **Naim Beça - LVV**
 3. **Besnik Salihu- LDK**
 4. **Ekrem Livoreka- AAK**
 5. **Dardana Tafili-Dauti - Ekzekutivi i komunës**
 6. **Ardiana Tusha- OJQ (KVRL)**
 7. **Përfaqësues nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal**
3. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga radhët e anëtarëve të komisionit të përcaktuar si në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Detyrat e komisionit janë të caktuara në Rregulloren Nr.01/2020 Për Ndryshim Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2018 Për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës së Kaçanikut.
5. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
7. Ky vendimi hyn në fuqi 15 pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikqyrës- MAPL, respektivisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit; Kryetari i Komunës; Drejtoria e Administratës së Përgjithshme; Drejtoria për Buxhet dhe Financa; Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë; dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 15.07.2022 Nr. 020-584
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës	
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.104/02-16421/22, për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal	

I/ nderuar Kryetar,
I/ nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 04.07.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimit Nr.104/02-16421/22, për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe:

KONFIRMON

- Vendimin Nr.104/02-16421/22, për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal *eshte në pajtim* me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2022, ka miratuar Vendimin Nr.104/02-16421/22, për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut është bazuar në nenin 12.1 dhe 40.2 pika (e) e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Udhëzimi Administrativ Nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës, i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut *me datë 27.06.2022, më 26 Për, 0 Kundër dhe 0 Abstenime.*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.